

KONTRATË
SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 30 /05 /2023, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

Z.Arian Gani Karroci, i datëlindjes 31.05.1968, identifikuar me letërnjoftimin ID me numër personal G80531115H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e **Shitësit**).

DHE


Shoqërisë SUPERIOR GROUP shpk, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT K91712015L, me seli në adresën Farkë SAUK, Autostrada Tiranë - Durrës, Zona Kadastrale nr. 3266, përfaqësuar nga administrator **Altion Memushi** i datëlindjes 29.03.1973 identifikuar me letërnjoftimin ID me numër personal H30329070G (në cilësinë e **Blerësit**).

OBJEKTI: Shitja e 55.010 (pesedhjetë e pese mijë e zero dhjetë) aksioneve të “BANKA CREDINS” sh.a, që zotërohen nga aksionari **Z.Arian Karroci** dhe blerja e tyre nga shoqëria **SUPERIOR GROUP shpk**.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria “BANKA CREDINS” sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal NR. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS



Palët kanë rënë dakord që 55.010 (pesedhjetë e pese mijë e zero dhjetë) aksione të shiten me çmimin 10.637.150 (dhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesedhjetë) Leke.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 55.010 (pesedhjetë e pese mijë e zero dhjetë aksione) të shoqërisë “BANKA CREDINS” sh.a, pjesë e paketës së aksioneve të tij, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.


Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 10.637.150 (dhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesedhjetë) Leke nga ana e Blerësit shoqëria **SUPERIOR GROUP shpk**, në llogarinë e Shitësit **Z.Arian Karroci**

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejthe tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.



TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËSI

Arian KARROCI

Arian Karroci




BLERËSI

Shoqëria SUPERIOR GROUP shpk

Përfaqësuar nga

Administratori

Altion MEMUSHI

Altion Memushi
